

Shërimi i të Sëmurëve



Plaku Dallin H. Ouks, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dha mësim se besimi është thelbësor që mrekullitë të ndodhin:

“Besimi është i domosdoshëm për shërimin me anë të fuqive të qiellit. Libri i Mormonit madje mëson se, ‘po të mos ketë besim mes fëmijëve të njerëzve, Perëndia nuk mund të bëjë mrekulli mes tyre’ (Ethëri 12:12) [shih edhe 1 Nefi 7:12; DeB 35:9]. Në një bisedë të shquar në lidhje me administrimin e të sëmurëve, Presidenti Spenser W. Kimball tha: ‘Nevoja për besim shpesh nënvlerësohet. I sëmuri dhe familja e tij shpesh duken sikur varen plotësisht te fuqia e priftërisë dhe te dhurata e shërimit të cilën ata shpresojnë se mund ta kenë vëllezërit që administrojnë, mirëpo përgjegjësia më e madhe është tek ai i cili bekohet. . . . Elementi më kryesor është besimi i njeriut, kur ai person është i vetëdijshëm e i përgjegjshëm. “Besimi yt të ka shëruar” [Mateu 9:22] përsëritej nga Mjeshtri aq shpesh, sa pothuajse u bë një refren’ [“President Kimball Speaks Out on Administration to the Sick”, *New Era*, tetor 1981, f. 47]” (“Shërimi i të Sëmurëve”, *Ensign ose Liahona*, maj 2010, f. 49).



Plaku Dallin H. Ouks na kujtoi edhe se një pjesë e rëndësishme e të pasurit besim është gatishmëria për të pranuar vullnetin e Perëndisë:

“Ndërsa ushtrojmë fuqinë e padyshimtë të priftërisë së Perëndisë dhe ndërsa e ruajmë si thesar premtimin e Tij që Ai do ta dëgjojë e do t’i përgjigjet lutjes së bërë me besim, ne duhet të mbajmë mend se besimi dhe fuqia shëruese e priftërisë nuk mund të sjellin një rezultat të kundërt me vullnetin e Atij e të cilit është priftëria. Ky parim mësohet në zbulesën që udhëzon se pleqtë e Kishës do t’i vënë duart mbi të sëmurët. Premtimi i Zotit është se ‘ai që ka besim në mua për t’u shëruar dhe nuk caktohet për vdekjen, do

të shërohet’ (DeB 42:48; theksimi i shtuar). Në ngjasim me këtë, në një tjetër zbulesë moderne Zoti shpall që, kur dikush ‘kërkon sipas vullnetit të Perëndisë . . . do të bëhet ashtu si ai kërkon’ (DeB 46:30) [shih edhe 1 Gjon 5:14; Helamani 10:5].

Prej gjithë kësaj kuptojmë që edhe shërbëtorët e Zotit, duke ushtruar fuqinë e Tij hyjnore në një rrethanë ku ka besim të mjaftueshëm për t’u shëruar, nuk mund të japin një bekim të priftërisë i cili do t’i sjellë shërim një personi, nëse ai shërim nuk është vullneti i Zotit.

Si fëmijë të Perëndisë, që njohim dashurinë e Tij të madhe dhe diturinë maksimale se çfarë është më e mira për mirëqenien tonë të përgjeshme, ne i mirëbesojmë Atij. Parimi i parë i ungjillit është besimi tek Zoti Jezu Krishti, dhe besim do të thotë mirëbesim. E ndjeva atë mirëbesim në bisedën që një kushëri i imi i imi dha në funeralin e një vajze adoleshente e cila kishte vdekur nga një sëmundje e rëndë. Ai tha këto fjalë, të cilat në fillim më tronditën e më pas më ngritën në shpirt: ‘Unë e di se ishte vullneti i Zotit që ajo të vdiste. Asaj iu dha trajtim i mirë mjekësor. Iu dhanë bekime të priftërisë. Emri i saj që në listën e lutjeve në tempull. Ajo u bë tema e qindra lutjeve për rikthimin e shëndetit të saj. Dhe unë e di se ka mjaft besim në këtë familje sa që ajo do të ishte shëruar, po të mos ishte vullneti i Zotit që ta merrte në shtëpi në këtë kohë.’ Po atë mirëbesim e ndjeva në fjalët e babait të një tjetër vajze të zgjedhur, jeta e së cilës u mor nga kanceri në moshën e saj adoleshente. Ai shprehu: ‘Besimi i familjes sonë është tek Jezu Krishti dhe nuk varet nga rezultatet’. Ato mësimë mua më tingëllojnë të vërteta. Bëjmë gjithçka që mundim për shërimin e një njeriu të dashur dhe pastaj ia besojmë rezultatit Zotit” (“Shërimi i të Sëmurëve”, *Ensign ose Liahona*, maj 2010, f. 50).

